



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 11.
Prishtinë, më 26.05.2015 në ora 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Agim Çeku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Fisnik Ismaili, Rustem Berisha, Milka Vuletić, Saša Milosavljević, Slavko Simić, Čerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Emrat e pjesëmarrësve në mbledhje : përfaqësues nga OSBE-ja Ardiana Gashi, përfaqësues të MAP-së N Shala, përfaqësues nga KTV- Norë Shabani, TV- Kosova Live Sanije Jusufi, RTK-2 Jelena Dordevic, përfaqësuese e Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković** –kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 29.04.2015 dhe 6.05.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-30 për Përgjimin e Telekomunikimeve, me amandamente të Komisionit funksional për Integritet Evropian;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-19 për Avokadin e Popullit, me amandamente të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-20 për Barazi Gjinore, me amandamente të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi , me amandamente të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja, jeni në dijeni se shqyrtimi i projektligjeve siapas agjendës së ditë së sotme kanë ardhur në kuadër të përmbushjes së kriterëve për liberalizim të vizave nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh se nuk jemi komision funksional për projektligjet në kuadër të këtij procesi, nuk do të thotë se nuk bie në përgjegjësi në fushën e këtij komisioni, pasi këto ligje janë të rëndësishme dhe kanë ndikim për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Andaj hapi debat me arsye që anëtarët e komisionit të deklarohet nëse ka ndonjë propozim konkret në procedim të mëtejshëm.

Veton berisha- përgëzoj kryetarën për detyrën e re dhe shpreson se do kemi bashkëpunim korrekt. Fillimisht ishte i mendimit që rendi i ditë së të shtyhet për ditën e nesërme. Shprehu pakënaqësinë e tij lidhur me praktikën e miratimit në pako të projektligjeve, sepse nuk sjellin efekte të sukseshme. Bazuar në rëndësinë që kanë këto projektligje ai konsideron se mirë është të shqyrtohen dy pikat e para ndërsa propozoi që pikat 5 dhe 6 të shtyhen për ditën e nesërme, me arsye të kemi afat në dhënjen e amandamenteve apo komenteve konkrete.

Cerim Bajrami, pasi projektligjet janë ardhë në procedurë të përshpejtuar, nuk e sheh të arsyeshme kërkesën e kolegëve që mbledhja të shtyhet për ditën e nesërme, sepse nuk do të ndryshohet situata aktuale. Mendon se e vetmja pikë e rendit të ditës - shqyrtimin e Projektligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mund të ndikojë në një farë mase në pozitën e komuniteteve jo-shumicë. Gjithashtu tha se do të ishte ngarkesë e dyfishtë nëse do të shqyrtohen nëntë projektligjet në të njëjtin takim.

Lidhur me këtë çështje diskutuan edhe anëtari **Danush Ademi** dhe **Agim Kikaj**, duke shprehur mendimin e tyre se është detyrim obligues që projektligjet në procedurë të përshpejtuar të shqyrtohen dhe miratohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në kuadër të afateve, nuk ka kohë për të kërkuar afat shtesë pasi të njëjtat do të procedohen ditën e enjte për lexim të dytë, në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit, kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 29.04.2015 dhe 6.05.2015;

Kryesuesja - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjeve të mbajtura më 29.04.2015 dhe 6.05.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-30 për Përgjimin e Telekomunikimeve, me amandamente të Komisionit funksional për Integritet Evropian;

Kryesuesja- paraqet për shqyrtim Projektligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve me Raport amendamente të Komisionit Funksional dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 05/L-30 për Përgjimin e Telekomunikimeve dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

III. Gjithashtu, Komisioni shqyrtoi edhe propozim amandamentete e deputetit Bekim Haxhiu dhe Nahit Hasani , dhe të njejtat nuk janë përkrahur.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-19 për Avokadin e Popullit, me amendamente të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;

Kryesuesja- paraqet për shqyrtim Projektligjin Nr.05/L-19 për Avokadin e Popullit dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin i cili do t'i dërgohet Komisionit Funkcional.

Meqë nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të Raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin Nr.05/L-19 për Avokadin e Popullit dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-20 për Barazi Gjinore, me amendamente të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin Nr.05/L-20 për Barazi Gjinore me Raport amendamente të Komisionit Funkcional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr.05/L-20 për Barazi Gjinore dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi , me amendamente të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin Nr.05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Raport amendamente të Komisionit Funkcional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr.05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Të ndryshme

1. Kryesuesja – theksoi se në takimin e kaluar, Komisioni ka formuar grupet punuese lidhur me zhvillimet procedurale të monitorimit të ligjeve, të bazuara në Planin e punës për vitin 2015. Pas konsultimeve, Komisioni ka emëruar kryetarët dhe anëtarët e grupeve punuese, me këtë përbërje:

- 1.1 Grupi punues për monitorimin e Ligjit për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit
 - Kryetare: Jasmina Živković,
 - Anëtarë: Sasa Milosavljević, Slavko Simić, Mufera Sinil dhe Fisnik Ismaili.
- 1.2 Grupi Punues për monitorimin e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës:
 - Kryetar : Veton Berisha,
 - Anëtarë ; Ćerim Bajrami, Milka Vuletić, Agim Kikaj, Mufera Šinik.
- 1.3 Grupi Punues për monitorimin e Ligjit për Vetëqeverisja Lokale.
 - Kryetar : Agim Kikaj,
 - Anëtarë; Daush Ademi dhe Rustem Beriša

2. **1. Veton Berisha**- ai propozoi që në një mbledhje të radhës, Komisioni të thërras ministrin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, z Dalibor Jevtić, me qëllim të ofrimit të informatave për politikën të cilat i zhvillon ministria Juaj në lidhje me integrimin e komunitetit pakicë në Kosovë, ndarja proporcionale e investimeve për komunitetin pakicë dhe

Me propozimin e Veton Berisha, u pajtuan anëtarët dhe Komisioni njëzëri nxorri këtë:

Përfundim

*Në mbledhje të Komisionit të ftohet ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim zot, Dalibor Jevtić, që të raportoj për integrimin e komunitetit pakicë në Kosovë, ndarja e fondeve për komunitete dhe **për realizimin e planeve për këtë vit**. Për realizimin e mbajtjes së mbledhjes, do të njoftoheni me kohë.*

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković